



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1117/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala, Fejzullah Rexhepi, Rafet Haxhaj, Nenad Lazić, Afijete Sada - Glllogjani, Zyhdi Haziri, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seli në Prishtinë, dega në Dragash, lidhur me parregullsi në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 01.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli e parashtruar nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seli në Prishtinë, dega në Dragash, me shenjë ZL.Anr.1117/2017, të datës 30.11.2017, paraqitur lidhur me parregullsi në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, për Kryetar të Komunës së Dragashit.

A r s y e t i m

Më datën 30.11.2017, PZAP-i, ka pranuar apelin me numër ZL.Anr.1117/2017, të parashtruar nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në seli në Prishtinë, dega në Dragash, me të cilën ka theksuar se gjatë shqyrtimit të përgjithshëm të procesit zgjedhor, operacioni i votimit përmes postës, mbi bazën edhe të raportimeve të vëzhguesve të saj në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, ka vërejtur shumë parregullsi të cilat cenojnë rëndë procesin zgjedhor në Komunën e Dragashit. Më tej ka theksuar se pjesëmarrja e votuesve përmes procesit të votimit me postë ka qenë e shtuar, gjithsej 230, ndryshe nga trendi i përgjithshëm i votimit përmes postës. Në bazë të raporteve të vëzhguesve të subjektit të tyre nga QNR, del se shumica e plikove janë të ngjashme, në kuptim të formatit por edhe të mënyrës së votimit, si dhe të vetë përcaktimit të tyre për kandidatin. Nga procesi i votimit me postë del se nga 230 vota në total, kandidati Selim Kryeziu, ka marrë 0 (zero) vota, ndërsa kandidati Shaban Shabani ka marrë 230 vota ose totalin e votave me postë. Me këtë rastë parashtruesi i ankesës pretendon se nga parregullsitë e cekura del se ky proces është zhvilluar në kundërshtim të plotë me parimet e njohura ndërkombëtare të fshehtësisë së votës, votimit individual lirisë së përcaktimit të njohura dhe të përvetësuar edhe nga legjislacioni përkatës në fuqi i Republikës së Kosovës, konkretisht, në kundërshtim me nenin 3 nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Andaj nga PZAP-i ka kërkuar që apeli të pranohet si e bazuar dhe të anulohet në tërësi procesi i votimit përmes postës për Komunën e

Dragashit dhe rezultati i votave me postë për secilin kandidat për Komunën e Dragashit të përjashtohet nga rezultati përfundimtarë i zgjedhjeve për Kryetarë të Komunës së Dragashit.

Parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve në apel, ka bashkangjitur deklaratat me shkrim të vëzhguesve të subjektit të tyre si dhe Listën e rezultateve të votave me post për të gjitha komunat.

Në përgjigje në ankesë të datës 30.11.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka theksuar se: në bazë të nenit 6 dhe 7 të Rregullës Zgjedhore për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, dhe Rregullës 03/2013 për votim jashtë vendit, QNR-ja bënë verifikimin e zarfeve dhe fletëvotimeve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve përmes postës, ku së pari konstaton se a janë në përputhje me Rregullën për Votim Jashtë Vendit Nr. 03/2013 si dhe Rregullës zgjedhore të QNR-së. Po ashtu Sekretariati-Njësia e Votimit jashtë Kosovës i dorëzojnë zarfet e fshehtësisë të konfirmuara me shënimet për identifikim të bashkangjitura dhe të klasifikuara në bazë të komunave, te Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Pastaj QNR-ja, më pas i procedojë zarfet dhe fletëvotimet e votuesve Jashtë Kosovës, në bazë të dispozitave të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.06/2013 mbi QNR-në. KQZ nuk do ti numërojë fletëvotimet që janë dërguar nga Votimi Jashtë Kosovës nëse nuk i plotëson kriteret e parapara sipas Rregullës Zgjedhore për Votim Jashtë Kosove 03/2013.

KQZ-ja, në vazhdim ka shtuar se i gjithë dokumentacioni i votimit përmes postës mund të ofrohet për hetim, verifikim apo konstatim të gjendjes faktike nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës, vërtetoi se apeli është i pa bazuar, pasi që votat për të cilat pretendohet se janë të manipuluar janë gjithsejtë 230 fletëvotime, të cilat nuk kanë ndikim në rezultatin final të zgjedhjeve për kryetar të komunës së Dragashit, sepse kandidati i PDK-se në këtë komunë i ka 6579 vota ndërsa kandidati i LDK-së 6303 vota edhe po të anuloheshin të gjitha fletëvotimet me poste prap kandidati i PDK-se do të ketë 46 vota më shumë se kandidati i LDK-se apo gjithsej 6549 vota. Prandaj fletëvotimet e kontestuar nga parashtruesi i ankesës konsiderohen nga paneli si pa ndikim në rezultatin final.

Andaj, Paneli duke u bazuar në nenin 120 par.1 pika b) të LZP-së, konstatoi se në rastin konkret ndryshimi eventual i votave, në mes të dy kandidatëve në garën zgjedhore për kryetar të komunës së Dragashti, nuk ka ndikim në rezultatet finale, për këto arsye dhe në kuptim të nenit 117, 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1117/2017 me datën 01.12.2017



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.